



NVO MLADI ROMI



UNIONI RROM KORÇE



Udruzenje "Mladi Romi" Vitez



Doracak

mbi mjetet e lobimit dhe avokimit

Mundësitë e financimit për OJQ-të rome të Ballkanit Perëndimor



Funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

projekti ERASMUS+

"Roaming - Ngritja e kapaciteteve të organizatave rome për financimin nga BE-ja dhe ndërtimin e partneritetit" (573137-EPP-1-2016-1-ME-EPPKA2-CBY-ËB)

Përmbledhje

1. Rreth projektit "Roaming"	2
2. Qëllimi i doracakut	3
3. Trajnimi për ngritjen e kapaciteteve	4
4. Qëndrimi në Bruksel	5
5. Realitetet kombëtare - Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen romët në:.....	9
• Bosnje dhe Hercegovinë	
• Serbi	10
• Shqipëri.....	11
• Kosovë	12
• Mal të Zi	13
• Maqedoni	14
6. Dokumentet e Avokimit të zhvilluara gjatë aktivitetit të qëndrimit në Bruksel.....	15
7. Punëtori Projektesh – gjenerimi i IDEVE për adresimin e sfidave të njohura.....	22
8. Mundësitë e financimit	
• ERASMUS +	25
• Instrumenti për ndihmën e para-antarësimit –“IPA”.....	29
• Instrumenti Evropian për Demokraci dhe Të Drejtat e Njeriut–“IEDDNJ/EIDHR”.....	31
• ROMACT	32
9. Organizatat partnere	33

1. PËR PROJEKTIN "ROAMING - NGRITJA E KAPACITETEVE TË ORGANIZATAVE ROMË PËR FINANCIMIN NGA BE-JA DHE NDËRTIMIN E PARTNERITETIT", BASHKËFINANCUAR NGA PROGRAMI ERASMUS + I BE-SË

Ideja e projektit është ndërtuar mbi nevojën për të zhvilluar kapacitetet e OJQ-ve romë nga vendet e Ballkanit Perëndimor për të shfrytëzuar më efektivisht fondet e BE-së dhe në këtë mënyrë të forcojnë angazhimin e tyre për të sjellë më shumë perspektivë evropiane për komunitetet lokale romë, nëpërmjet nismave cilësore të avokimit. Projekti ka për qëllim të forcojë kapacitetet e OJQ-ve në Ballkanin Perëndimor për të mbështetur reformat e BE-së, për të avokuar për integrimin në BE dhe për t'u bërë një mbikëqyrës i politikave të BE-së në lidhje me çështjet e përfshirjes së romëve.

Ekipi i projektit ka vërejtur se Organizatat e Shoqërisë Civile Romë në Ballkanin Perëndimor nuk kanë njohuri të mjaftueshme për fondet e disponueshme të BE-së që mund t'u ndihmojnë atyre të trajtojnë sfidat lokale, kombëtare dhe rajonale me të cilat ballafaqohet popullata e ketyre vendeve. Për më tepër, ata nuk posedojnë kapacitetin e kërkuar për të aplikuar dhe menaxhuar fonde të tilla. Komisioni Evropian dhe numri i organizatave të tjera ndërqeveritare dhe ndërkombëtare shpesh shprehin shqetësimin e tyre mbi disavantazhet dhe kushtet e vështira të jetesës së popullatës romë, por OJQ-të romë si partnerët më me përvojë dhe më të nevojshëm nuk inicojnë partneritete strategjike, nuk aplikojnë për fonde të BE-së dhe nuk i shfrytëzojnë fondet që janë në dispozicion.

Duke pasur këtë si pikënisje, ekipi i projektit ka projektuar projektin **"Roaming - Ngritja e kapaciteteve të organizatave romë për financimin nga BE-ja dhe ndërtimin e partneritetit"** për të krijuar një strukturë lehtësuese për shoqërinë civile (pro) romë për të marrë pjesë aktive në politikën lokale dhe kombëtare dhe procesin e vendimmarrjes dhe vendosjen e një dialogu konstruktiv dhe sistematik me autoritetet dhe OJQ-të romë për të ndikuar në politikat mbi integrimin e romëve, përfshirjen sociale, mosdiskriminimin, dialogun ndëretnik, zhvillimin socio-ekonomik dhe të drejtat e qytetarëve.

Objektivat specifike të projektit ishin:

- 1) për të forcuar kapacitetin profesional, legjitimitetin dhe llogaridhënien e OJQ-ve (pro) romë dhe për të përmirësuar një planifikim strategjik afatgjatë organizativ,
- 2) për të forcuar kapacitetin e organizatave (pro) romë për të krijuar së bashku një dialog konstruktiv dhe sistematik me autoritetet dhe për t'i mbajtur qeveritë të përgjegjshme në procesin e vendimmarrjes dhe proceseve të zbatimit të politikave,
- 3) të ndërtojnë besimin, njohuritë, aftësitë dhe udhëheqjen e të rinjëve romë dhe grupeve lokale romë për të avokuar për ndryshime strukturore në sektorin publik lokal duke krijuar partneritete strategjike me akterët e tjerë të OJQ-ve, institucionet lokale, komunat dhe politik-bërësit,
- 4) të nxisin rrjetëzimin e rregullt të OJQ-ve (pro) romë në nivel rajonal dhe të BE-së dhe të lehtësojnë shkëmbimin e njohurive, shkathtësive dhe lidhjeve dhe rritjen dhe zgjerimin e ndikimit të tyre në fushata dhe avokim.

Përmes realizimit të projektit u arritën këto rezultate:

- Është përmirësuar kapaciteti profesional, legjitimiteti dhe llogaridhënia e OJQ-ve që japin një kontribut të çmuar në procesin e politikës dhe vendimmarrjes dhe në procesin e përgjithshëm të reformave.
- Dialogu i përmirësuar me autoritetet vendore dhe kombëtare dhe partneritetet e themeluara.

- Rrjetëzimi funksional i OJQ-ve (pro) rome në nivel rajonal dhe të BE-së që përkrahin dhe bashkëpunojnë në mënyrë proaktive me akterët tjerë, përcjellin aktivitete të përbashkëta dhe të mësuarit reciprok;
- Ngritja e vetëdijes për arsyet e përjashtimit shoqëror të romëve dhe 'rrugët' deri tek heqja e përjashtimit;
- Janë krijuar partneritetet strategjike me institucionet lokale, komunat dhe politik-bërësit;
- Pjesëmarrja aktive në rrjetin ERGO dhe përfitimi nga bashkëpunimi, rrjetëzimi dhe shkëmbimi me anëtarët e tij dhe rrjeti i akterëve të tijnë Evropë.

Grupet kryesore të synuara të "Roaming" ishin OJQ-të aktive në rrjetin "Roma SIMURGH" - një platformë shumë e kualifikuar joformale, e krijuar për të fuqizuar OJQ-të rome dhe për të avokuar për rritjen e mundësive të punësimit, për të promovuar mjete inovative për luftë gjithëpërfshirëse kundër anti-ciganizmit, për të sfiduar konceptet e udhëheqjes brenda komunitetit rom dhe për të diskutuar haptazi për migracionet e romëve në Evropë. Përfitues të këtij projekti ishin organizatat e shoqërisë civile rome nga Ballkani Perëndimor që zhvilluan kapacitetet e nevojshme gjatë gjithë këtij procesi.

2. QËLLIMI I KËTIJ DORACAKU

Publikimi¹ para jush është një doracak që mund të përdoret si një vegël që mbulon fushat e mëposhtme:

- Strategjitë e projekteve për romët në Ballkanin Perëndimor dhe në BE me mundësitë konkrete të financimit dhe këshillimit;
- Udhërrëfyes i BE-së për lobim për OJQ-të rome në Ballkanin Perëndimor;
- Këshilla nga të rinjtë romë për përmirësimin e përpjekjeve të OJQ-ve të romëve kur avokojnë për përfshirjen e romëve në Ballkanin Perëndimor;

Do të jetë kombinimi i këshillave praktike dhe praktikave unike nga projekti, duke përfshirë mësimet e nxjerra nga nismat e avokimit dhe planet tematike për avokim. Do të publikohet në 500 kopje në gjuhën angleze dhe do të përkthehet në gjuhët lokale.

¹ Publikimi u përkthye nga organizata Advancing Together, Kosovo

3. TRAJNIMI I NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE

Trajnimi u organizua në kuadër të projektit Roaming me qëllim të zhvillimit të kompetencave të pjesëmarrësve në mekanizmat e financimit të BE-së përfshirë këtu Erasmus +, IPA dhe EIDHR. Programi ka përfshirë ciklin e menaxhimit të projekteve, menaxhimin financiar me fokus në procedurat e aplikimit, prioritetet, zhvillimin e partneritetit, ndërtimin e urës midis problemit kombëtar dhe financimit të BE-së dhe aspekte të tjera të rëndësishme të Financimit Evropian dhe mekanizmave mbështetës. Trajnimi gjithashtu ka përfshirë trajnimin një ditor për në avokimin dhe lobimin e BE-së me qëllim që të forcoj aftësitë e partnerit për të avokuar rreth çështjeve të rëndësishme për romët në debatet e politikave.

Ka pasur theks të veçantë në lidhjet midis Bashkimit Evropian dhe shoqërisë civile, si dhe mekanizmat që mbrojnë legjislacionin e BE-së dhe procedurat buxhetore. Pritjet ishin që pjesëmarrësit në fund të kësaj pjese të jenë në gjendje të përgatisin një letër avokuese në një faqe për një çështje të caktuar lokale / kombëtare të romëve dhe të propozojnë veprim avokues. Trajnimi përbëhej nga katër seanca në ditë me nga 90 minuta, si dhe aktivitete pas darke siç është parashikuar në agjendën origjinale. Për sesionet e parashikuara kanë ligjeruar trajnuesit me përvojë të gjerë në fushën e financimit të BE-së, Avokimit të Romëve, Integrimin në BE dhe Zhvillimin e Kapaciteteve.

Arsimi joformal është përdorur si një metodologji kyçe në këtë trajnim. Puna u fokusua për të nënkuptuar mësimnxënie duke ofruar mendime ekspertësh, ndarjen e përvojave, punën e përbashkët, punën në grup dhe diskutime. Trajnerët përdorën prezantime, përpunim të koncepteve, hyrje, materiale të shkruara si artikuj dhe ilustrime dhe studime të rasteve. Metodatat aktive që janë përdorur përmbanin simulime të situatave të dhëna, duke punuar në grupe, diskutime në panele, këshilla dhe loja (energizers).

Trajnimi është paraparë që të i rris njohuritë e pjesëmarrësve, të rris kuptimin dhe përmirësimin e aftësive të tyre.

Përzgjedhja e problemit prioritar rreziqet dhe pasojat e tij ishte hapi i parë drejt hartimit të përgjigjeve ndaj zgjidhjes së problemeve.

Gjatë paragrafëve të mëposhtëm, sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet komuniteti rom në vendet e përmendura janë dhënë në një formë të përmbledhjes së shkurtër të raporteve shtetërore për proceset e integritetit të romëve.



4. QËNDRIMI NË BRUKSEL



Gjashtë përfaqësues të OJQ-ve patën mundësi të mësojnë nga praktikat 4 javore në Bruksel të dizajnuara për të ndihmuar organizatat rome të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor për të kuptuar më mirë se si funksionojnë fondet e BE-së, Shoqëria Civile Europiane, strukturat e BE-së dhe Parlamenti i BE-së. Objektivi kryesor ishte të ndërtohet bashkëpunimin midis OJQ-ve rome nga Ballkani Perëndimor dhe një numër të ombrellave përkatëse evropiane, si dhe të stimulohet përfaqësim evropian i romëve.

Qëndrimi është organizuar në disa faza dhe praktiantët patën 4 javë të plota me aktivitete dhe mundësi të mësim:

- Java e parë – Prezentimi dhe njohja me njëri-tjetrin, Hyrje në tema siq janë avokimi, lobimi në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare
- Java e dytë – Vizita dhe rrjetëzimi me organizatat ndërkombëtare
- Java e tretë – Visita dhe avokim drejt institucioneve ndërkombëtare
- Java e katërt – Përmbyllja dhe përgatitja e planeve të ardhshme



Lista e organizatave/institucioneve relevante për organizatat e shoqërisë civile që kanë marr pjesë në Qëndrimin në Bruksel që do të mund të përdoshin si burim për OJQ-të tjera

Organizata	Info	Koment
SHEP/ EPA	Shoqata Evropiane e Projekteve (SHEP/EPA) është organizatë jofitimprurëse e pavarur politikisht e fokusuar në hulumtim dhe zhvillim, inovacion dhe ndërkombëtarizim. Përdorimi i teknologjive inovative të informacionit dhe të komunikimit është një veçori dalluese e këtij rrjeti bashkëpunues dedikuar akterëve të projekteve evropiane.	https://europeanprojects.org info@europeanprojects.org
RREKR/ ENAR	RREKR/ENAR (Rrjeti Evropian Kundër Racizmit) është rrjeti i vetëm mbarë-evropian anti-racist që kombinon avokimin për barazinë racore dhe lehtëson bashkëpunimin midis akterëve të anti-racizmit të shoqërisë civile në Evropë. Organizata u krijua në vitin 1998 nga aktivistët bazë në një mision për të arritur ndryshime ligjore në nivel evropian dhe për të bërë përparim vendimtar drejt barazisë racore në të gjitha vendet anëtare të BE. Që atëherë, ENAR është rritur dhe ka arritur shumë.	info@enar-eu.org
RSHM/ YEU	Të Rinjët për Shkëmbim dhe Mirëkuptim (RSHM/YEU) u themelua në Strasburg në vitin 1986 nga një grup prej 120 të rinjesh nga 11 vende të ndryshme. Në vitin 1989 ne ishim të njohur si një shoqatë anëtare e Byrosë Koordinuese Evropiane (B.K.E.). Sot ne jemi anëtar të Forumit Rinor Evropian, i cili është platforma e pavarur për INGYO dhe NYC në Evropë. Kemi të rinjë nga mbi 30 vende nga Evropa dhe Afrika të përfshirë në aktivitetet tona. Si një rrjet ndërkombëtar, ne jemi trupi përfaqësues i anëtarëve tanë në kontaktet me institucionet dhe partnerët në fushën e të rinjëve.	info@yeu-international.org
FRE/ YFJ	Forumi Rinor Evropian (FRE) është platforma e organizatave rinore në Evropë. Duke përfaqësuar 100 organizata rinore, edhe si Këshilla Kombëtare të Rinisë edhe si Organizata Joqeveritare Rinore Ndërkombëtare, ne besojmë se organizatat rinore janë mjet përmes të cilit ne fuqizojmë, inkurajojmë, përfshijmë, përfaqësojmë, arrijmë dhe mbështesim të rinjtë. Forumi Rinor bashkon dhjetëra miliona të rinjë nga e gjithë Evropa, të organizuara në mënyrë që të përfaqësojnë interesat e tyre të përbashkëta.	youthforum@youthforum.org

Rrjeti ERGO – zyra në Bruksel Rue d'Edimbourg 26	RRJETI I ORGANIZATAVE EVROPIANE ROME ME VEPRIM LOKAL RRËNJËSOR (RROERVRR/ERGO) Rrjeti ERGO është një organizatë e re dhe dinamike e themeluar në vitin 2008 nga një grup i vogël i OJQ-ve që besuan se realitetet e përditshme të komuniteteve rome nuk u morën parasysh në zhvillimin dhe zbatimin e politikave. E krijuar mbi një filozofi të përbashkët të qytetarisë aktive, përgjegjësisë së përbashkët dhe fuqizimit rrënjësor, anëtarët e Rrjetit të ERGO-së synojnë të bindin hartuesit e politikave se ndryshimi pozitiv për Romët është i mundur kur të njihet anticiganizmi dhe trajtohet si shkak rrënjësor i pabarazisë me të cilën ata përballen dhe kur parakushtet për romët plotësohen që edhe ata të marrin pjesë në jetën qytetare si palë të barabarta	http://www.ergonet.org g/ergo-net.org/
SEKRETARIATI I ZERI/ ERIO Address: Avenue Edouard Lacomblé 17, kati i dytë, 1040 Bruksel, Belgjikë Telefoni : +32 (2) 733 34 62	Zyra Evropiane Rome e Informimit (ZERI/ERIO) u themelua në vitin 2003 si një organizatë jofitimprurëse sipas ligjit belg, duke punuar me një fushë ndërkombëtare dhe evropiane. Pavarësisht nga roli që ne luajmë në advokimin e të drejtave të romëve në nivel evropian, nuk kërkojmë të zëvendësojmë ndonjë organizatë tjetër rome. Si një platformë informative, ERIO siguron që zyrtarët e BE-së dhe qeveritë të dëgjojnë zërat e të gjithë romëve evropianë. Puna jonë aktualisht përqendrohet në politikat kundër diskriminimit në fushat e arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor dhe strehimit.	http://erionet.eu/belgium office@erionet.eu
Federata Ndërkombëtare e Lidhjes së të Drejtave të Njeriut	FNDNJ/FIDH (Federata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut) është një OJQ ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që bashkon 184 organizata nga 112 vende. Që nga viti 1922, FIDH ka mbrojtur të gjitha të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Për FIDH, shoqëritë transformuese mbështeten në punën e akterëve lokal. Prandaj, aktivitetet e FIDH-së synojnë të përforcojnë kapacitetet e tyre dhe ndikimin e tyre. Ajo vepron në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar në mbështetje të anëtarëve dhe organizatave partnere për të trajtuar abuzimet e të drejtave të njeriut dhe për të konsoliduar proceset demokratike. Punën e përqendron tek shtetet dhe ata në pushtet, siç janë grupet e armatosura të opozitës dhe korporatat shumëkombëshe. Përfituesit kryesorë të saj janë organizata kombëtare për të drejtat e njeriut të cilët janë anëtarë të FIDH-ut, dhe përmes tyre edhe viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut. FIDH gjithashtu bashkëpunon me organizata të tjera lokale partnere dhe akterët ndryshim.	https://www.fidh.org/en/about-us/contact -1776/
FREMOS/FEMY SO (Forumii të	Vizioni ynë është të mundësojmë që secila organizatë anëtare të arrijë potencialin e saj të plotë brenda	http://www.femyso.org http://www.femyso.org/con

Rinjëve Evropian Musliman dhe Organizatave Studentore)	shoqërisë evropiane dhe kështu të kontribuojë në zhvillimin e një Evrope të larmishme, gjithpërfshirëse dhe të begatë. Misioni ynë është të lehtësojmë zhvillimin, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin midis rinisë muslimane evropiane dhe organizatave studentore dhe të jemi zëri i tyre përfaqësues në të gjitha institucionet evropiane.	tact
Rom en Rom ASBL	Gjatë Asamblesë së Përgjithshme të saj në Bullgari në nëntor të vitit 2012, TernYpe vendosi të krijojë një plan të përbashkët trajnimi ndërkombëtar, i cili kontribuon në punën e organizatave anëtare, në prioritetet vjetore të ternYpe, në zhvillimin e identitetit të rrjetit, ndërtimin e kapaciteteve të aktivistëve të rinj, udhëheqësve të rinj, trajnerëve dhe lehtësuesve/facilitatorëve. Fushata Rinore Evropiane e TernYpe qëndron për respekt të ndërsjellë dhe përgjegjësi të GJITHËSISË në një shoqëri. Ne qëndrojmë kundër ekstremizmit, anticiganizmit, racizmit, stigmatizimit dhe diskriminimit në Evropë.	https://data.be/fr/societe/Rom-En-Rom-ASBL-0848260743 https://www.facebook.com/rom.enrom
Partneriteti BE KiE	Partneriteti rinor i BE-KiE rrjedh nga marrëdhëniet e ngushta që kanë zhvilluar Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian në fushën e të rinjëve.	
Komisioni Evropian	Komisioni Evropian është krah ekzekutiv politikisht i pavarur i BE-së. Është vetëm përgjegjës për hartimin e propozimeve për legjislacionin e ri evropian.	
Parlamenti Evropian	Faqja zyrtare e Parlamentit Evropian, organi legjislativ i zgjedhur direkt i Bashkimit Evropian. Roli: Trupi i zgjedhur direkt i BE-së me përgjegjësi legjislative, mbikëqyrëse dhe buxhetore; Anëtarët: 751 deputetë (deputetë të Parlamentit Evropian)	
Këshilli i Evropës (zyra në Bruksel)	Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e të drejtave të njeriut në kontinent. Ai përfshin 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtarë të Bashkimit Evropian.	

5. REALITETET KOMBËTARE-VËSHTIRËSITË KRYESORE ME TË CILAT BALLAFAQOHEN ROMËT

• Bosnja dhe Hercegovina

Romët janë pakica më e madhe kombëtare në Bosnje dhe Hercegovinë. Për më tepër, sipas të dhënave të disponueshme të mbledhura gjatë procesit të evidentimit të nevojave të romëve dhe hulumtimeve të tjera, romët janë pakica më e rrezikuar sipas të gjitha parametrave socialë që matin dhe përcaktojnë statusin e çdo komuniteti ose grupi social. Nga të gjitha pakicat kombëtare në Bosnjë e Hercegovinë asnjë pakicë kombëtare nuk është në një pozitë sociale e cila është me peshën dhe vështirësinë e saj të ngjashme me pozitën e pakicës rome. Romët janë të pranishëm pothuajse në tërë territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, më saktësisht 71 komuna. Përjashtimi social i popullsisë rome kryesisht reflektohet në faktin se si individë ashtu edhe tërësi komuniteti është i marginalizuar nga shoqëria dhe për këtë arsye pengohen të marrin pjesë në përpunime me kapacitetin e tyre të plotë në zhvillimet ekonomike, shoqërore dhe kulturore; kjo është kryesisht rezultat i varfërisë dhe / ose mungesës së njohurive themelore, arsimit dhe mundësive të punësimit.

Kjo pozitë e individëve rom dhe / ose i këtij grupi minoritar në tërësi i largon romët në aspektin e mundësive arsimore dhe të punësimit dhe kështu kufizon aftësinë e tyre për të gjeneruar të ardhura. Për këtë arsye, shumë anëtarë të komunitetit rom janë të përjashtuar dhe nuk marrin pjesë në ngjarjet shoqërore apo në aktivitete të tjera të komunitetit. Bosnja dhe Hercegovina ka pranuar Dekadën e Romëve si një model praktik për zhvillimin e standardeve dhe metodologjive të përshtatshme, për krijimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve në luftën kundër varfërisë me të cilën ballafaqohet popullata rome dhe për trajtimin e përjashtimit dhe diskriminimit të tyre brenda kornizës rajonale.

Në bazë të përmbajtjes së Strategjisë së Bosnjës dhe Hercegovinës për trajtimin e çështjeve rome dhe qëllimet e Dekadës së Romëve, si dhe duke marrë parasysh faktin se romët në BH janë komuniteti më i rrezikuar, sipas të gjitha parametrave socioekonomikë, në 2008, Këshilli i Ministrave i BH miratoi Planin e Veprimit të BH për trajtimin e çështjeve rome në fushën e punësimit, strehimit dhe kujdesit shëndetësor.

Gjetjet e hulumtimit zbuluan se pakicat etnike në BH janë diskriminuar në disa baza. Pozita e popullit rom është veçanërisht shqetësuese. Përveç formave të ndryshme të diskriminimit, shfaqja e incidenteve të motivuara nga urrejtja nuk është e pazakontë. Organet e zbatimit të ligjit dhe prokuroria, si dhe gjykatat në Bosnje dhe Hercegovinë nuk marrin masat e duhura për të identifikuar motivin e urrejtjes dhe për t'i trajtuar këto raste si krime të urrejtjes. Bosnja dhe Hercegovina ka një rrugë të gjatë para se të arrijë të sigurojë respekt për të drejtat e pakicave etnike dhe krijimin e kushteve për statusin e tyre të barabartë në shoqëri.

Të dhënat ekzistuese tregojnë probleme të shumta në lidhje me sigurinë e romëve. Popullsia rome është e marginalizuar, e papunë dhe e përjashtuar nga shoqëria, e cila duhet të merret si një faktor kontribues për ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve të sigurisë. Kjo kryesisht rezulton ngase shumica prej tyre jetojnë në kushte të vështira të banimit që shpesh nuk plotësojnë as kriteret bazë të sigurisë dhe ku rreziku i zjarrit ose i përmbytjes është shumë më i lartë se sa në njësitë banesore që plotësojnë kriteret e sigurisë. Ekzistojnë edhe aktivitete të tjera ilegale në të cilat shpesh romët detyrohen të marrin pjesë në mënyrë që të mbijetojnë, kryesisht për shkak të shkallës së lartë të papunësisë. Si rezultat ato janë shpesh të ekspozuar ndaj abuzimeve verbale dhe sulmeve fizike. Kur prona e tyre shkatërrohet, autorët e krimit kurrë nuk dërgohen para drejtësisë. Dhuna ndaj grave në Bosnjë dhe Hercegovinë, veçanërisht në formën e dhunës në familje, është një problem i madh, si dhe trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzimin e detyruar të punës dhe trafikimin e fëmijëve për shfrytëzim të punës përfshirë këtu edhe kërkim-lëmoshën e detyruar.

• Serbia

Çështjet kyçe të përfshirjes sociale të romëve në Serbi janë mungesa e arsimit dhe papunësisë. Përtej vuajtjes ekonomike, romët e Serbisë bartin ngarkesa joproporcionale për shkak të stigmës që mbart identiteti i tyre.

Serbia është një vend me popullatë prej 7,310,555 personash, shumë prej të cilëve jetojnë në rrethana të vështira ekonomike - por joaq sa pakica romë.

Rreth një e katërta e të gjithë serbëve janë të papunë, por për Romët shkalla e papunësisë është mbi 60%. Gati dy të tretat e romëve jetojnë në vendbanime pa ujë të pijshëm dhe më shumë se tre të katërtat jetojnë pa asnjë sistem kanalizimi. Një në katër romë i mungon edhe qasja në energji elektrike.

Më shumë se gjysma e romëve nuk janë të arsimuar në krahasim me një të pestën e serbëve dhe jo-romëve dhe një e pesta e fëmijëve romë kanë ndjekur vetëm shkollën parashkollore. Nga të gjithë fëmijët romë që regjistrohen në shkollën fillore, 70% deri në 90% e braktisin atë në një moment. Diskriminimi social dhe vështirësitë financiare familjare pengojnë fëmijët romë, si dhe politikat e rrepta të shkollës dhe mungesa e mbështetjes akademike. Autoritetet serbe konsiderojnë arsimin si çelësin e avancimit ekonomik për romët, por vetëm 8% e romëve mbarojnë shkollën e mesme ose nivelin e ngjashëm, dhe më pak se një përqind arrijnë shkollimin universitar.

Në mesin e të gjitha dallimeve të rënda që përjetojnë romët në Serbi, gratë dhe vajzat romë janë në situatë edhe më të rëndë. Sot në Serbi, pothuajse të gjitha gratë romë janë të papunë dhe 80% janë funksionalisht analfabetë. Ndarja sociale e romëve nuk është karakteristikë vetëm për Serbinë. Në pothuajse të gjitha vendet evropiane ekziston një problem ndarjes sociale, diskriminimit dhe marginalizimit të romëve. Bashkimi Evropian ka nisur një rekomandim për të gjitha vendet e Evropës për të formuluar strategji specifike kombëtare për integrimin e romëve. Pas Dekadës Rome (2005) dhe në përputhje me synimet e përfshirjes sociale të romëve, u formulua një "Kornizë e BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve 1" (SKIR). Si pjesë përbërëse e saj, u përcaktuan katër fusha kyçe në të cilat duhet të arrihet përparimi me qëllim të përmirësimit të përfshirjes së romëve: arsimi, punësimi, strehimi dhe kujdesi shëndetësor. Kur është fjala për Serbinë, në Strategjinë Kombëtare për Përfshirjen e Romëve 2 është theksuar se mbi 60% e romëve në Serbi jetojnë në varfëri.

Ekzistojnë dy faktorë kryesorë që janë gjeneruesit e privimit social të romëve dhe ato janë niveli i ulët i arsimit dhe papunësisë. Këto dy probleme janë shumë të ndërlidhura; kështu që niveli i ulët i arsimit është një nga pengesat kryesore për punësim. Gjithashtu është theksuar se ka diskriminim institucional ndaj romëve në aspektin e punësimit. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nuk ka të dhëna të sakta për përqindjen e romëve të papunë. Është theksuar se Plani Kombëtar i Veprimit për Punësim brenda Dekadës Rome nuk është zbatuar në mënyrë sistematike. Kjo është arsyeja pse romët janë të angazhuar kryesisht në ekonominë gri. Në Strategji thuhet se dy arsyet kryesore të privimit social të romëve janë: niveli i ulët i arsimit dhe shkathtësive dhe diskriminimi që ekziston nga shumica. Një nga prioritetet kryesore të identifikuara nga Strategjia është "integrimi dhe riintegrimi i romëve në tregun e punës". Arritja e këtij objektivi inkurajohet në disa mënyra, njëra prej të cilave është vetëpunësimi i Romëve. Në këtë mënyrë, në Strategji është insistuar që çdo program punësimi duhet të përfshijë një komponent edukative për të ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të romëve në aspektin e arsimit dhe kualifikimeve profesionale. Përfshirja sociale e romëve është pjesë përbërëse e agjendës së të gjitha vendeve të BE-së dhe problemet e përfshirjes janë të ngjashme në pothuajse të gjitha këto vende.

• Shqipëria

Romët ballafaqohen me barriera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në qasjen në shërbimet publike, që rrjedhin nga kriteret e përshtatshmërisë që ata nuk mund t'i binden, mungesës së informacionit ose të kuptuarit të procedurave administrative, si dhe stigmës dhe qëndrimit të shpeshtë diskriminues nga popullata shumicë. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e tyre të jetesës, trajtimin nga popullata shumicë dhe marrëdhëniet me institucionet qeveritare. Studiimet tregojnë se niveli i varfërisë në mesin e romëve është dy herë më i lartë se popullsia shumicë, ndërsa shkalla e papunësisë është tre herë më e lartë se mesatarja.

Romët në Shqipëri njihen si një minoritet etnik-gjuhësor. Burimet zyrtare thonë se në Shqipëri ka rreth 1,300 romë, megjithatë burime të tjera vlerësojnë se ka deri në 120,000 romë në Shqipëri; popullsia është 3.4 milion. Regjistrimet zyrtare në Shqipëri i njohin romët. Komunitetet rome gjenden në të gjithë vendin; më i madhi gjenden në Shqipërinë qendrore dhe juglindore. Shqipëria iu bashkua Dekadës së Përfshirjes së Romëve në vitin 2008; Në kuadër të kësaj kornize qeveria miratoi një Plan Kombëtar të Veprimit i cili përqendrohet në arsim, punësim dhe mbrojtje sociale, strehim dhe infrastrukturë, shëndet, infrastrukturën sociale dhe mundësitë e barabarta dhe trashëgiminë kulturore. Në vitin 2006, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miratoi një plan veprimi për romët në fushat e kulturës, rinisë dhe sportit; i cili synon të rrisë ndërgjegjësimin e traditave rome dhe të krijojë mundësi të barabarta për integrimin e të rinjve romë në shoqëri. Në shtator 2003, qeveria shqiptare miratoi një Strategji Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Romëve, e cila trajton kushtet e banimit nën standard, papunësinë dhe arritjen e ulët të arsimit.

Romët në Shqipëri jetojnë në kushte të këqija në vendbanime, pa lidhje me infrastrukturën bazë, si uji, shërbimet elektrike dhe publike. Ka pasur raste të dëbimeve me forcë dhe rasteve në të cilat autoritetet shqiptare kanë diskriminuar Romët në ofrimin e shërbimeve sociale, pagesave të mirëqenies sociale, ofrimit të infrastrukturës komunale dhe kujdesit shëndetësor.

Në përputhje me Ligjin për Arsimin, Në Shqipëri shkollimi është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët mbi moshën gjashtë vjeçare. Për fat të keq, shumë fëmijë romë braktisin shkollën para se të përfundojnë tetë vitet e shkollimit të detyrueshëm. Vlerësimet jozyrtare tregojnë se frekuentimi i shkollave të mesme të romëve në Shqipëri është shumë i ulët, ndërsa 72% e fëmijëve shqiptarë ndjekin shkollën e mesme të mesme. Nuk ka bursa për të mbështetur arsimin e romëve në Shqipëri. Sipas një studimi të UNDP-së, rreth 52% e romëve nuk kanë arsim, 18% kanë vijuar vetëm disa vjet të shkollës fillore dhe vetëm 14% kanë arritur të përfundojnë shkollën fillore; vetëm 3% e të anketuarve romë kishin mbaruar shkollën e mesme dhe vetëm 4% ishin diplomuar në kolegji ose universitet. Gratë rome në përgjithësi kanë nivel më të ulët të arsimit sesa meshkujt: 56% nuk kanë arsim, ndërsa 11% braktisin shkollën fillore. Prindërit romë kanë trajtim diskriminues nga mësuesit dhe studentët e tjerë dhe distanca të mëdha ndërmjet shtëpive dhe shkollave të tyre shihet si arsye shpesh për shkallën e ulët të shkollimit. Për shkak të varfërisë, shumë fëmijë romë duhet të punojnë për të kontribuar në të ardhurat e familjeve. Rreth 15% e fëmijëve romë të anketuar duhej të braktisnin shkollimin për të punuar. Familjet rome kanë vështirësi në qasjen në kujdesin shëndetësor adekuat. Shumë fëmijë në familjet e mëdha rome vuajnë nga kequshqyerja, e cila ndikon në shëndetin e tyre të përgjithshëm dhe aftësinë për të studiuar. Shumë romë në Shqipëri nuk arrijnë të punësohen për shkak të kualifikimeve të ulëta arsimore dhe diskriminimit. Shumica e romëve mbijetojnë nga puna e rastësishme informale në bujqësi, shërbim publik dhe ndërtim me paga shumë të ulëta. Të ardhurat mesatare mujore për një familje rome janë 68 euro ndërsa në mesin e familjeve jo-rome që jetojnë në të njëjtin afërsi është 174.50 euro.

Nuk ka zyrtarë të zgjedhur romë në nivel kombëtar ose lokal në Shqipëri. Megjithatë ata marrin pjesë në zgjedhje, votuesit romë përbëjnë një pjesë shumë të vogël të elektoratit. Partitë politike në përgjithësi inkurajojnë dhe mobilizojnë romët për të votuar gjatë fushatës dhe procesit të zgjedhjeve, por shpesh neglizhojnë shqetësimet e tyre pas zgjedhjes.

• **Kosova***²

Përkundër rritjes ekonomike relativisht të fortë gjatë viteve të fundit, tregu i punës i Kosovës po përballet me sfida të mëdha të karakterizuara nga nivele të larta të papunësisë dhe pasivitetit. Normat e papunësisë në Kosovë janë ndër më të lartat në Evropë. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave socio-ekonomike të të gjitha komuniteteve në Kosovë është një fushë ku mbetet shumë për t'u bërë. Në përgjithësi, nivelet e punësimit në Kosovë mbeten të ulëta, meqë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës dhe komunitetet tjera vulnerabël janë të prekur veçanërisht. Mungesa e mundësive për punësim në përgjithësi, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, mbetet një sfidë e rëndësishme për arritjen e progresit drejt integritetit të tre komuniteteve. Vlen të theksohet se gratë dhe të rinjtë në mesin e tre komuniteteve janë veçanërisht të prekur në këtë drejtim.

Raporti i Bankës Botërore për Kosovën 2016 dhe bazuar në Vlerësimin e punësimit të komuniteteve pakicë në Kosovë, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit bëjnë vetëm 0.5% të të punësuarve në shërbimin publik dhe 0.1% në ndërmarrjet publike, ndërsa pjesa më e madhe e mungesës së mundësive për punësim duhet të fajësohet për diskriminimin dhe trajtimin e pabarabartë.

Strategjia për Integritetin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2017-2021 është miratuar nga qeveria e Kosovës në prill të vitit 2017, dhe ashtu si në dokumentin e mëparshëm monitorimi do të bëhet nga qeveria e Kosovës.

Për të siguruar zbatimin e strategjisë është thelbësore që të ketë pjesëmarrje aktive dhe efektive të shoqërisë civile romë, ashkali dhe egjiptase sidomos në monitorim.

Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë përjetojnë një shkallë të ulët të regjistrimit në shkollë dhe / ose shkallë të ulët të ndjekjes, si dhe ndikohen nga shkalla e lartë e braktisjes, sidomos tek vajzat dhe regjistrimin e vonshëm pas moshës gjashtë vjeçare.

Disa nga faktorët kontribuojnë në këtë situatë, duke përfshirë shkallën e varfërisë ekstreme midis tre komuniteteve, nivelet e ulëta të arsimit dhe ndërgjegjësimin e ulët për rëndësinë e arsimit mes tre komuniteteve, tensione ndëretnike, ngacmimi dhe diskriminimi në shkollë dhe mungesa e mësimdhënësve Rom, ashkali dhe egjiptian. Raporti i Progresit i Kosovës në vitin 2016 deklaroi se Qendrat Mësimore vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e numrit të madh të braktisjes së shkollës dhe në zhvillimin e integritetit të mëtejshëm të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor. Qeveria vazhdon të ofrojë libra falas për fëmijët e moshës shkollë; megjithatë studentët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë shkallë më të ulët të regjistrimit, shkallë më të lartë të braktisjes dhe nivele të ulëta të performancës akademike.

Ndërkohë që është bërë progres në mbylljen e kampeve të kontaminuara nga plumbi në pjesën veriore të Mitrovicës, zgjidhjet e qëndrueshme të strehimit ende mungojnë për mijëra familje nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës. Në përgjithësi, Qeveria nuk ka kryer vlerësime të nevojave për strehim ose nuk ka zhvilluar strategji komunale dhe qendrore të strehimit. Më konkretisht, institucionet e Kosovës ende nuk kanë një strategji gjithëpërfshirëse për të parandaluar dhe rregulluar vendbanimet joformale të banuara nga tre komunitetet.

² Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës

• Mali i Zi

Sipas regjistrimit të popullsisë 2011, në Mal të Zi janë 8305 romë dhe egjiptianë (6251 romë dhe 2054 egjiptianë). RE përbëjnë 1.32% të popullsisë së përgjithshme dhe jetojnë në 7 nga 24 komuna në Mal të Zi. OJQ-të dhe organizata ndërkombëtare vlerësojnë se numri real i popullsisë RE në Mal të Zi është 20,000. Ndër faktorët e tjerë, si mungesa e vullnetit për vetëdeklarimin etnik dhe / ose kufizimet teknike për të arritur tek popullata migruese, arsyeja për këtë mospërputhje është fakti se shumë romë dhe egjiptianë kanë status ligjor të pazgjidhur dhe janë "të padukshëm" ndaj statistikave zyrtare.

Siç raportohet nga Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave në vitin 2016, shumica e popullsisë RE - 77% e tyre jetojnë në vendbanime të ndara, kryesisht në komunat Podgoricë, Nikshiq dhe Berane. Komuniteti RE ndikohet dukshëm nga të gjitha llojet e diskriminimit dhe privimi social, duke përfshirë statusin ligjor të parregulluar, varfërinë, papunësinë, shkallën e ulët të arsimit, rrezikun e lartë të sëmundjeve infektive dhe kronike, dhunën, rreziqet mjedisore etj. Siç raportohet nga Anketa E Indikatorëve të Shumëfishtë (EISH/MISC), gratë dhe fëmijët janë më të privuarit popullsisë në mesin e romëve dhe egjiptianëve dhe janë të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe diskriminimit shtesë.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, ndërgjegjësimi i përgjithshëm i publikut mbi çështjet e romëve në shoqërinë malazeze është rritur padyshim dhe është bërë progres i caktuar në drejtim të zbatimit të rekomandimeve kryesore të Dekadës së Përfshirjes së Romëve dhe Strategjisë për Përmirësimin e Statusit të RE. Në përputhje me Dekadën e Përfshirjes së Romëve (2005-2015), qeveria malazeze krijoi një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për romët, përfshirë Planin Kombëtar të Veprimit për Dekadën Rome (2005), Strategjitë për Përmirësimin e Statusit të RAE - NRIS (2008-2012, 2012-2016 dhe 2016-2020), Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave (2006), Ligji për Shtetësinë Malazeze (2008 dhe 2011) dhe Ligji për të Huajt (2009).

Sidoqoftë, kuadri ligjor dhe politik nuk është zbatuar plotësisht, për shkak të mungesës së vullnetit politik, burimeve financiare dhe kapaciteteve administrative të autoriteteve qendrore dhe lokale. Gjithashtu mungesa e kapaciteteve administrative, brenda qeverive për të angazhuar më shumë romët dhe egjiptianët për të marrë pjesë në krijimin e politikave, pengon planifikimin dhe zbatimin e duhur të politikave. Shumica e problemeve vazhdojnë dhe komunitetit i mungojnë ende shërbimet thelbësore.

Sipas Vëzhgimit të Dekadës së Romëve, është e qartë se ka mungesë të burimeve njerëzore në administratën publike në nivel kombëtar dhe lokal për t'u marrë me këto çështje, si dhe mungesa e vullnetit politik për ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatimin e legjislacionit dhe strategjive, si p.sh mungesa e planeve lokale të veprimit, duke përfshirë kryeqytetin Podgoricën, në territorin e së cilit jeton numri më i madh i anëtarëve të popullsisë RE.

OJQ-të në Mal të Zi mbështesin rritjen e kapacitetit të aktivistëve romë për të monitoruar zbatimin e këtij dokumenti të Strategjisë në nivel kombëtar dhe për të punuar me komunat për të zhvilluar plane lokale të veprimit për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve. Përmirësimi i vërtetë i pozitës së popullsisë RE nuk mund të arrihet pa pjesëmarrjen e tyre të duhur në jetën publike. Duhet të zhvillohen aftësitë dhe kapacitetet e romëve dhe egjiptianëve të rinj për të marrë pjesë në jetën publike.

• Maqedonia³

Me një sipërfaqe prej 25.713 km², në dhjetor 2007 vendi kishte një popullsi prej 2.045.177 banorë në 85 komuna të populluara. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2002, 62% e popullsisë ishin maqedonas, shqiptarë 25.2%, 3.9% turq, 2.7% romë, serbë 0.2%, ndërsa grupet tjera plotësuan 3.8% të mbetur. Si pasqyrim i përbërjes multietnike, kushtetuta e shtetit përban nene që garantojnë të drejtat e pakicave. Romët njihen si një kombësi me të gjitha të drejtat, liritë dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Të vendosur në zonat urbane, shumica e qytetarëve romë jetojnë në Shkup, Prilep, Kumanovë, Manastir, Tetovë, Gostivar, Shtip dhe Koçan. Anëtarët e këtij nacionaliteti janë identifikuar në më shumë se 50 komuna. Përkundër të dhënave zyrtare në nivel lokal, shpesh OJQ-të po tregojnë mundësinë e një numri më të madh të qytetarëve romë. Arsytet për dallimet në lidhje me statistikën zyrtare janë numri i madh i qytetarëve romë pa dokumente identiteti, migrimi ekonomik i romëve në një qytet tjetër dhe jashtë vendit, mungesa e vetëdijes nga ana e komunitetit rom për rëndësinë e regjistrimit dhe arsye të tjera. Në përgatitjen e këtij programi janë marrë parasysh të dhënat zyrtare.

Sfidat kryesore të identifikuar nga Shtetet Anëtare, të cilat janë shumë të pajtueshme me politikën dhe masat që një vend duhet të ndërmarrë në lidhje me Romët, janë si vijon:

- krijimi i kushteve për një rritje të integritetit në tregun e punës për ata që janë më të papunë dhe grupet vulnerabel që janë të varfër dhe të përjashtuar nga shoqëria;
- sigurimin e sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale që ofrojnë fonde minimale që sigurojnë një jetë të mirë, por gjithashtu eliminon mungesën e motivimit për kërkim të punës;
- zhvillimi i programeve për vazhdimin e arsimit, sidomos të grupeve të prekshme dhe tejkalimin e braktisjes së parakohshme të sistemit arsimor;
- përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbimet publike, veçanërisht në shëndetësi, shërbime sociale, strehim dhe transport;
- tejkalimi i nivelit të lartë të përjashtimit social dhe diskriminimit, veçanërisht të grupeve të caktuara etnike, si romët dhe grupeve të tjera të rrezikut, si njerëzit që jetojnë në institucione dhe persona me aftësi të kufizuara;
- forcimi i politikave për mbështetjen e familjes, rrjeteve shoqërore dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Romët janë shumë aktivë në skenën politike: ka nëntë parti politike romë në qeveri dhe në opozitë. Situata e punësimit të romëve mbetet një nga faktorët më shqetësues që pengon pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri. Edhe pse ka pak përmirësime në shkallën e punësimit dhe aktivizmit të romëve, ata ende kanë papunësi pothuajse dy herë më shumë se mesatarja kombëtare dhe madje edhe më e lartë në mesin e grave romë. Situata aktuale me nivelin e arsimimit të përgjithshëm të romëve është e pakënaqshme. Edhe pse përfundimi i arsimit fillor dhe të mesëm është i rregulluar me ligj, megjithatë ekzistojnë devijimet e dukshme. Analfabetizmi ose niveli i ulët arsimor në këtë kategori të popullsisë, vazhdon të detyrojë spiralin e varfërisë, kështu edhe shkallën e lartë të papunësisë.

³ Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

6. DOKUMENTET E AVOKIMIT TË ZHVILLUARA GJATË AKTIVITETIT TË QËNDRIMIT NË BRUKSEL



Plani i Zhvilluar i Avokimit në Shqipëri: Organizata Disutni Albania

Në diskursin publik në Shqipëri, romët përcaktohen kryesisht në një narrativë të përzier midis marginalizimit të tyre si dhe veçantisë së tyre si një komunitet pakicë etniko-gjuhësor. Kjo lidhet me dukshmërinë e marginalizimit të tyre dhe historisë së përbashkët të diskriminimit në Shqipëri. Për DISUTNI ALBANIA, pikënisja për të dyja është zhvillimi dhe përhapja e njohurive përmes mediave. Ne besojmë se njerëzit e informuar kanë mundësi më

të mëdha për të marrë pjesë në mënyrat e tyre në shoqërinë e gjerë dhe kështu të shfrytëzojnë çfarëdo mundësie për fuqizimin e tyre. Çështjet kryesore për të diskutuar në avokimin e mediave: 1-Tejkalimi i barrierave në komunitet përmes punës së përditshme me fëmijët dhe fëmijët në shkollë, për një të ardhme të garantuar për ta.

Romët kanë qenë dhe ende janë subjekt i getoizimit, diskriminimit dhe ndarjes; ata janë të ekspozuar ndaj racizmit në të gjitha nën-sistemet e shoqërisë: ekonomia, politika, kultura, arsimit, informacioni. Specialistët e shumtë në komunitetin rom, duke kërkuar një zgjidhje të rëndësishme për "të ardhmen e romëve" më shpesh në ekonomi dhe në hapësirën politike, nuk arrijnë të kuptojnë se format më të dhimbshme të getoizimit dhe diskriminimit ekzistojnë në sferën e arsimit, informacionit dhe kulturës. BE mund të kontribuojë duke i dhënë Disutni Albania mundësinë për të zhvilluar një projekt lokal i cili mund të zgjerohet në nivel kombëtar, lidhur me përhapjen e informacionit përmes librave, ligjëruesve, intervistave me dëshmitë e anëtarëve të komunitetit rom, veçanërisht me tregimet e suksesshme të romëve të rinj të cilët kanë korrur sukses në karrierën e tyre.

2-Edukimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor BE mund të kontribuojë duke nxitur politikën kombëtare në Shqipëri për të krijuar një kontroll më të mirë të fëmijëve romë që duhet të regjistrohen në sistemin e detyrueshëm shkollor. BE gjithashtu mund të stimulojë organizatat nacionale romë për të krijuar programe të posaçme për të ndihmuar ata fëmijë që e braktisën shkollimin. Në këtë kontekst përfshirja e popullatës shumicë mund të diskutohet në veprimin si një alternativë e dobishme për të vazhduar me këto objektivat.

3- Tejkalimi i stereotipeve për romët përmes informacioneve kulturore. Një nga gjërat më të rëndësishme është të japim informacion në lidhje me historinë tonë, gjuhën tonë dhe rrënjët tona. Njohja e historisë dhe kulturës romë mund të ndihmojë në ndërtimin e një ndjenje më të mirë të bashkëjetesës në shoqërinë shqiptare. BE-ja mund të promovojë një nismë kulturore për të përhapur këtë informacion në lidhje me kulturën romë, gjuhën romë dhe traditën në nivel kombëtar. Në fund, Disutni Albania është e bindur se romëve duhet t'u lejohej të marrin drejtimin në mbështetjen e komuniteteve të tyre dhe duke artikuluar nevojat dhe interesat e komunitetit të tyre duke patur të gjithë hapësirën e nevojshme në transmetimet e medias. Dëshira jonë është që në Shqipëri të krijojmë një rrjet të komunitetit, Zërat e Romëve në Shqipëri, por për këtë qëllim ne kemi nevojë për mbështetje ndërkombëtare dhe kombëtare.



Plani i Zhvilluar i Avokimit Bosnjedhe Hercegovinë Organizata Mladi Romi Vitez

Organizata është themeluar më 2011, me iniciativë të një numri të madh të të rinjve, si organizata civile, jopolitike dhe jofitimprurëse. Objektivi kryesor për krijimin e organizatës ishte përqindja e lartë e diskriminimit të romëve, sidomos e të rinjtëve, përqindja e ulët e arsimit, kërkimi i lëmoshës dhe jetesa në zonat e depresionuara dhe pa avantazhë. Objektivat kryesore të organizatës janë: edukimi i të rinjve romë, lufta kundër diskriminimit dhe përfshirja e romëve në shoqëri, në sferën kulturore dhe sociale të jetës. Problemet kryesore të romëve në Bosnje e Hercegovinë janë:

- Arsimi
- Punësimi
- Kujdesi shëndetësor

ARSIMI-raporte dhe tregues të tjerë të burimeve të ndryshme, nga organizatat joqeveritare të specializuara vendore, organizatat ndërkombëtare, shoqatat profesionale dhe institucionet shkencore, tregojnë se një përqindje e lartë e fëmijëve rom nuk ndjekin shkollën fillore, braktisja e shkollës së mesme ose kolegjit bëhet për shkak të varfërisë dhe mbështetjes së pamjaftueshme për të vazhduar studimet e tyre. (Numri i nxënësve rom në shkolla të mesme ende nuk arrin në një mijë dhe mund të jetëm pak se dhjetë). Komisioni European duhet t'i rekomandojë Qeverisë së Bosnje Hercegovinës që të zbatojë masat afirmative për nxënësit rom duke i mbështetur familjet në nevojat e tyre themelore në bashkëpunim me komunën, qendrën social, ofrimin e numrit më të madh të bursave për nxënësit rom që vijnë shkollën e mesme dhe studimet universitare.

PUNËSIMI - Zbatimi tre vjeçar i Planit të Veprimit për Punësimin e Romëve nuk i ka përmbushur pritjet plotësisht. Objektivat e shumta të përcaktuara dhe masat mbështetëse nuk u mbështetën nga burimet e nevojshme dhe detyrat e përcaktuara qartë që do të çonin në arritjen e synimeve të caktuara. Nga njëra anë ka një numër arsyesh që kanë kontribuar në moszbatimin e objektivave ambicioze, siç janë ndryshimet e rëndësishme në mjedisin global që kanë ndodhur ndërkohë (kriza ekonomike, rritja e papunësisë, reduktimi në furnizim dhe në mungesë të mundësive për punësim për të gjithë, kufizimet e punësimit në institucionet publike etj.) dhe, nga ana tjetër, problemet e popullsisë rome (struktura e ulët e kualifikimit, mos regjistrimi në shërbimet e punësimit, veçanërisht i romëve të trajnuar dhe të kualifikuar, mungesa e aftësive dhe njohurive të kërkuara nga tregu i punës, etj.). Institucionet evropiane duhet t'i rekomandojnë Qeverisë së Bosnjës dhe Hercegovinës rishikimin e Planit të Veprimit për punësimin e romëve duke marrë parasysh prioritetet për punësimin e romëve dhe nevojat aktuale nga njëra anë dhe kufizimet ekzistuese financiare nga ana tjetër. Rrjedhimisht, gjatë planifikimit të fondëve të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve individuale, kufizimet maksimale kanë shkaktuar burimet e pakta në dispozicion. Në të njëjtën kohë, u përqëndrua në identifikimin e mekanizmave të reja të financimit për të përfshirë një larmi më të madhe të burimeve të financimit dhe qasjeve inovative për financim.

KUJDESI SHËNDETËSOR / Sipas të dhënave nga Regjistri i Nevojave Rome (në tekstin e mëtejshëm: RNR) dhe informatat e mbledhura në procesin e hulumtimit të kryer nga shoqatat rome si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit, kryesisht Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve, mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme. Në Bosnjë dhe Hercegovinë ka rreth 35,000 romë, bazuar në tregues të vërtetë, 16.771 persona ishin të përfshirë në regjistrin e nevojave të romëve (47.9%). Përafërsisht 30% e pakicës kombëtare rome të përfshirë në RNR nuk kanë sigurim shëndetësor. Sipas të dhënave nga Regjistri i Nevojave Rome, nga kjo 30% një total prej 5,200 personash ose 34,7% janë fëmijë deri në moshën 15 vjeçare që tregojnë mungesën e njohurisë së prindërve në lidhje me mjetet e qasjes në kujdesin shëndetësor. Brenda kornizës së Regjistrit të Nevojave Rome është vërejtur një shkallë e lartë e aftësive të kufizuara për grupmoshën deri në 14 vjet, me një përqindje të lartë të aftësisë së kufizuar (34.7%). Numri i saktë i fëmijëve që u kategorizuan nuk dihet. Federata e Bosnje dhe Hercegovinës ka një problem në lidhje me Ligjin e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës mbi Sigurimin Shëndetësor, pasi përcakton afatet për regjistrim në zyrat / shërbimet e punësimit dhe si rezultat i këtij Ligji shumica e romëve nuk kanë sigurim shëndetësor. Ky nuk është rasti me rregullat dhe praktikën në Republikën Srpska dhe Rajonin Brcko. Këto dispozita në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës duhet të ndryshohen gjatë procesit të miratimit të një projektligji për ndryshimet në ligjin që është aktualisht në fuqi. Kjo procedurë është e vazhdueshme dhe kërkon lobim të fuqishëm nga organizatat rome si dhe nga Bordi i Romëve me ndihmën e Komisionit Evropian.



Zhvillimi i Planit të Avokimit Kosovë: Organizata Advancing Together Kosovo

Papunësia

Bazuar në Raportin e Bankës Botërore për Kosovën 2016 dhe në vlerësimin e punësimit të komuniteteve pakicë në Kosovë, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit bëjnë vetëm 0.5% të të punësuarve në shërbimin publik dhe 0.1% në ndërmarrjet publike, ndërsa pjesa më e madhe e mungesës së mundësive për punësim duhet të fajësohet për diskriminimin dhe trajtimin e pabarabartë. Përkundër rritjes ekonomike relativisht të fortë gjatë viteve të fundit, tregu i punës i Kosovës po përballlet me sfida të mëdha të karakterizuara nga nivele të larta të papunësisë dhe pasivitetit. Normat e papunësisë në Kosovë janë ndër më të lartat në Evropë.

Strategjia e Kosovës për Intergrim

Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Romë Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë 2017-2021
Strategjia është miratuar nga qeveria e Kosovës në prill 2017, dhe ashtu si në dokumentin e mëparshëm monitorimi do të bëhet nga qeveria e Kosovës.

Për të siguruar zbatimin e strategjisë është thelbësore që të ketë pjesëmarrje aktive dhe efektive të shoqërisë civile romë, ashkallike dhe egjiptase të përfshirë në monitorim.

Arsimi

Raporti i Progresit i Kosovës në vitin 2016 deklaroi se Qendrat Mësimore vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e numrit të madh të braktisjes së shkollimit dhe në lehtësimin e integritetit të mëtejshëm të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor. Qeveria vazhdon të ofrojë libra falas për fëmijët e moshës shkollare, megjithatë studentët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë shkallë më të ulët të regjistrimit, shkallë më të lartë të braktisjes dhe nivele të ulëta të performancës akademike.



Plani i Zhvilluar i Avokimit Maqedoni: Organizata Romaversitas

Shtrirja e varfërisë në mesin e romëve në Republikën e Maqedonisë arrin në 88%, gjë që tregon gjendjen ekonomike të romëve. Të dhënat tregojnë se 85% marrin përfitime shtetërore, 70% të nivelit të papunësisë, 95% e romëve jetojnë në rajone më të varfra (geto) ose jetojnë në kushte periferike.

Romët ballafaqohen me përjashtim social për shkak të shkallës së varfërisë, mungesës së kualifikimeve dhe mundësive për mësim gjatë gjithë jetës dhe diskriminimit. Kjo përfshirje sociale distancon më tej Romët nga çdo perspektivë në lidhje me punësimin, të ardhurat, arsimin etj. Shkalla e regjistrimit të shkollave të mesme në mesin e romëve të moshës 16-19 vjeç, arrin në 27% në krahasim me 65% të popullsisë jo-rome. Tregues të tillë tregojnë dallimet ekzistuese në segmentin arsimor të popullatës rome dhe jo-rome. Diskriminimin në procesin e regjistrimit në universitet.

1. Mundësi të barabarta për arsim (bursa, mbështetje akademike-mentorim dhe tutorim, gjuhë, aftësi digjitale, aftësi praktike)

- Rritja e shkallës së regjistrimit, ndjekjes dhe diplomimit të romëve në universitete

Në lidhje me arsimin, të dhënat tregojnë se 22% e popullsisë rome nuk kanë arsimim formal krahasuar me 3% të popullatës tjetër jo-rome. Për më tepër, ekziston një mospërputhje në lidhje me normat e shkollimit. Përkatësisht, shkalla e shkollimit në mesin e romëve arrin në 60%, në krahasim me 99% mes maqedonasve dhe shqiptarëve përkatësisht. Është mjaft alarmante se shkalla e arsimit të mesëm në mesin e romëve të rinj të moshës 16-19 vjeç është 27% në krahasim me 65% të popullatës jo-rome. 22% e romëve nuk kanë arsim formal në krahasim me 3% të popullsisë jo-rome.

2. Edukimi cilësor i cili krijon mundësi reale në tregun e punës

- Kompetencat e kërkuar në tregun e punës

Shkalla e papunësisë në mesin e romëve arrin në 70% krahasuar me shkallën e papunësisë dukshëm më të ulët prej 31% në mesin e maqedonasve dhe 27% në mesin e shqiptarëve

3. Masat aktive për punësimin e nxënësve të shkollave të mesme të diplomuarve rom (aftësi profesionale, përvojë pune / stazhe, kualifikim dhe parakualifikim, mundësi të përjetshme për të rinjtë)

Plani i Zhvilluar i Avokimit Mali i Zi: OJQ Young Roma

OJQ Young Roma u regjistrua në maj të vitit 2005 si një organizatë jofitimprurëse lokale me qëllim të kontribimit në përmirësimin e gjendjes së romëve në Mal të Zi dhe integrimin e tyre të plotë në shoqërinë malazeze. Prandaj, vizioni i organizatës sonë është: burrat dhe gratë romë si qytetarë të barabartë, të arsimuar dhe aktivë të Malit të Zi. Aktivitetet e romëve të rinj janë kryesisht të përqendruara në punën me komunitetin dhe monitorimin e zbatimit të planeve vepruese kombëtare dhe lokale në fushën e përfshirjes sociale dhe integritit të romëve, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive, avokimin, promovimin dhe ndërmjetësimin në ushtrimin e të drejtave të pakicave.

-Strehimi: Kur është fjala për strehim, sidomos për të zhvendosurit e Kosovës, Mali i Zi ka punuar për këtë çështje dhe mund të themi se vendi po shkon në drejtimin e duhur, sepse përmes procesit të Sarajevës janë ndërtuar 120 apartamente dhe deri në shtator pritet të ndërtohen edhe disa shtëpi. Por, duhet bërë shumë përpjekje për të zgjidhur këtë çështje. Më shumë se 150 familje që jetojnë në kryeqytet në Mal të Zi ende kanë çështje të pazgjidhura të banimit. Prandaj, është e nevojshme të ndryshohet Ligji i banimit social, me qëllim të formimit të një fondi qeveritar, i cili do të përdoret për nevojat e ndërtimit të ndërtesës sociale dhe ndërtesave me qira preferenciale.

-Arsimi. Arsimi është fusha ku kemi rezultate të mira, sipas të gjitha raporteve të institucioneve shtetërore dhe organizatave të tjera që punojnë për përfshirjen e romëve në Mal të Zi sipas Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve, në vitin 2015-2016 numri i nxënësve në shkollat fillore ishte 1438, i cili është një hap i madh pozitiv. Por, problemet shfaqen më vonë (shkollën e mesme dhe arsimin e lartë), sepse cilësia e arsimit fillor kur është fjala për nxënësit romë është shumë e dobët, prandaj braktisja më vonë ndodh në shkollën e mesme ose nuk vendosin as të regjistrohen në shkollën e mesme për shkak të mungesës së mekanizmave cilësor mbështetës. Është më se e domosdoshme të kemi një program si Roma Versitas në Mal të Zi (një program i mentorimit dhe tutorimit) i cili duhet financuar nga akterët përgjegjës shtetërorë.

- Punësimi - Shumica e romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi jetojnë në varfëri, mezi mbijetojnë. Për shkak të procesit të tranzicionit dhe numrit të madh të personave të zhvendosur brenda vendit, vitin e kaluar është karakterizuar me njërënie edhe më dramatike në standardet e tyre të jetesës. Duke pasur parasysh nivelin e ulët të arsimimit të romëve dhe mungesën e investimeve dhe stagnimit ekonomik, mund të supozohet se gjendja e romëve në periudhën e ardhshme nuk do të përmirësohet ndjeshëm. Përveç "të varfërve të vjetër", do të shfaqen edhe "të varfërit e ri" - gjeneratat romë që do të vijnë dhe që nuk do të përgatiten për gjithë konkurrencën e ashpër në tregun e punës. Mesatarisht, në vit, në regjistrat e Agjencisë Shtetërore të Punësimit janë rreth 1000 persona që identifikohen si anëtarë të popullsisë romë dhe egjiptiane. Për të ulur pap-

unësinë e romëve nevojitet zbatimi i të gjitha dokumenteve strategjike në fushën e punësimit të popullatës romë në Mal të Zi, veçanërisht ato që njohin problemet specifike të romëve dhe pozitën e tyre në treg, si dhe një konsensusi dhe angazhim i institucioneve dhe organeve qeveritare të Malit të Zi (punëdhënësit, sindikatat, autoritetet e qeverisjes vendore dhe akterët e tjerë).



Plani i Zhvilluar i Avokimit Serbi: Shoqata E Koordinatorëve për Çështjet e Romëve

Qeveria e Republikës së Serbisë miratoi planin e veprimit për zbatimin e masave nga Strategjia. Edhe nëse qeveria e Serbisë nuk e respekton kuotën e caktuar lidhur me punësimin në sektorin publik, për pjesëmarrjen e romëve në institucione flitet tani e dhjetë vjet, por ende statusi i tyre ligjor nuk zgjidhet. Gjatë Dekadës Rome ishte e qartë se problemet kryesore janë: Punësimi, Arsimi, Strehimi dhe Qasja në kujdesin social dhe shëndetësor. Secila prej këtyre çështjeve lidhet me shkakun dhe pasojat.

- **PUNËSIMI** - Disa shembuj të mirë të punësimit të romëve janë Koordinatorët Romë, Ndihma Pedagogjike dhe Ndërmjetësuesit e Shëndetit të Romëve. Rezultatet e punës së tyre janë më se të dukshme. Ata janë akterët kryesorë më të rëndësishëm kur flasim për çështjet e romëve në Serbi. BE mund t'i rekomandojë Qeverisë së Serbisë zbatimin e pikave të mëposhtme.

- Është e nevojshme të përcaktohet roli i Koordinatorëve që është integruar zyrtarisht në strukturën e qeverisjes vendore. Përvoja e kaluar ka treguar se Koordinatorët kanë një faktor shumë të rëndësishëm në procesin e përfshirjes së romëve në nivel lokal, por edhe në nivel kombëtar, për të vazhduar procesin e përfshirjes së romëve është më e rëndësishme që Akti i klasifikimit të brendshëm i punës në vetëqeverisjet lokale ta siguroj pozicionin e Koordinatorëve por edhe të miratojë fondet e buxhetit komunal për aktivitetet për përmirësimin e gjendjes së romëve. Për më tepër, çështja e pozitës së Koordinatorëve Romë në të ardhmen dhe rëndësia e tyre e ardhshme në komunat dhe komunitetin e tyre po rritet kryesisht lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Kapitullin 23, Strategjia Kombëtare për Përfshirjen Sociale të Romëve. Projektet dhe masat lokale drejtohen tek Koordinatorët e Romëve dhe vetëqeverisjet lokale ku ata punojnë, të cilët ndajnë vlerat e një komuniteti dhe tregojnë një orientim të qartë ndaj përfituesve.

- **TË KTHYERIT NGA SHETETET E BE-SË DHE AZILKËRKUESIT** - Në Serbi në nivel vjetor, ose me vullnetin e tyre ose nën presion pas mohimit të kërkesave të tyre për azil, rreth 10.000 romë po kthehen nga Gjermania dhe rreth 5.000 romë vijnë nga vendet e tjera të BE-së, e cila vë presion të madh në sistem, dhe komunat vuajn më së shumti, ku edhe kthehen të kthyerit, thonë zyrtarët e UNDP-së në Serbi. Njerëzit që kthehen pasi kërkesa e tyre për azil në disa nga vendet e BE u refuzohet kthehen në vendet e tyre. Kjo është një tendencë shumë e pafatshme që është e dukshme për shumë vite, numrat po rriten me shpejtësi.

Institucionet e BE-së mund t'i rekomandojnë Qeverisë së Serbisë që të ofrojnë elemente për riintegrimin duke siguruar qasje më të mirë në Arsim, Punë, Kujdes Social dhe Shëndetësi. Secila komunë duhet të ketë në fondet e veta buxhetore mbulimin e shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve të tjera të paisjes me dokumentedhe për të ndihmuar në marrjen e dokumenteve shkollore nga jashtë në kohën më të shkurtër të mundshme dhe në nostrifikimin e tyre pa pagesë. Krijimi i mekanizmave mbështetës për të kthyerit sipas një marrëveshje mbi Riatdhesimin në përfaqësim para institucioneve dhe ofrimin e ndihmës juridike.

- **DISKRIMINIMI** - Romët përballen me diskriminimin dhe përjashtimin në të gjitha sferat e jetës. Ndërsa vajzat dhe gratë rome ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë. Numri i rasteve të anticiganizmit shoqëror, diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes ndaj romëve nga raporti i 124 ankesave për diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike të paraqitur tek Komisioneri për Barazi në vitin 2014, 40% i referohen diskriminimit ndaj Romëve. Numri i vogël i procedurave që kanë të bëjnë me diskriminimin e romëve trajtohen ndonjëherë në gjykata, gjë që çon në mosndëshkimin. Nga ana tjetër, diskriminimi kundër Romëve shprehet si në institucione dhe në jetën publike, ashtu edhe në sferën private. Në të ardhmen duhet të intensifikohen përpjekjet për të forcuar një kulturë të drejtave të njeriut dhe solidaritetit shoqëror për romët. Institucionet e BE-së mund t'i rekomandojnë Qeverisë së Serbisë që të avancojnë politikën kundër diskriminimit dhe ta zbatojnë atë së bashku me një politikë të multikulturalizmit integruar dhe dialogut ndërkulturor.

7. PUNËTORI PROJEKTESH – GJENERIMI I IDEVE PËR TË ADRESUAR SFIDAT E NJOHURA



"Punëtorja Evropiane e Projekteve për Romët" synon të rrisë interesin e organizatave lokale dhe kombëtare të romëve, sepse supozohet të jetë qendër për organizatat romë për të diskutuar së bashku rreth prioriteteve që komuniteti i tyre ka dhe mënyrat në të cilat ata mund të bëjnë iniciativë të përbashkëta për të avokuar për një projekt më të mirë legjislativ, por edhe plan që mund të financohet nga fondet e drejtpërdrejta të BE-së.

Pas kursit të trajnimit dhe praktikës, u organizuan Punëtori Projektësh dhe organizatat partnere që përfshinin përfaqësues të ndryshëm të OJQ-ve në një punëtori të hapur me stuhi mendimesh (brainstorming), krijuan ide për projekte avokimi për përfshirjen e romëve.

Punëtorja e Projektesve është një punëtori tematike e organizuar gjatë 2 ditëve të punës rreth temave të mëposhtme:

- (1) puna kundër diskriminimit të romëve
- (2) përfshirja sociale e të rinjve romë, dhe
- (3) zhvillimi i qëndrueshëm i OJQ-ve të romëve

Përfaqësuesit e OJQ-ve u takuan për të diskutuar idetë origjinale, të dakordohen për një ide të përbashkët dhe mënyra të reja për të shikuar iniciativat e avokimit të romëve në kontekstin e procesit të Integritimit në BE, duke krijuar propozime konkrete për përfshirjen e romëve që mund të zbatohen në nivel kombëtar në secilin vend nga vinin pjesëmarrësit e projektit.

në punëtori u angazhuan të paktën 12 përfaqësues të OJQ-ve të përzgjedhur nga partnerët. Punëtoritëmblohdën përfaqësues të organizatave me përvojë dhe ekspertizë në çështjet e Përfshirjes së Romëve.

Realizimi i "Iniciativave Evropiane e Punëtorive Rome" është zbatuar plotësisht nga organizatat partnere.

Projektet dhe iniciativat e avokimit janë iniciativë praktike që duhet të zbatohen në nivel lokal dhe kombëtar, nga OJQ-të që marrin pjesë në "Iniciativën Evropiane të Punëtorive Rome" pas Punëtorisë.

Si pjesë e planeve të tyre të avokimit, secili grup duhej të zbatonte një iniciativë avokimi në vendin e tyre duke përdorur mundësitë e financimit të BE-së dhe gjithashtu kapacitetin e tyre për ndërtimin e partneritetit të zhvilluar gjatë qëndrimit të tyre në Bruksel. Iniciativat e avokimit do të organizohen në nivel kombëtar duke trajtuar sfidat e minoritetit rom në kontekstin e procesit të integritimit evropian, veçanërisht në miratimin e parakushteve të BE-së dhe do të përqëndrohet në ndikimin e opinionit publik

Doracak

mbi mjetet e lobimit dhe avokimit

Mundësitë e financimit për OJQ-të rome të Ballkanit Perëndimor

në nivel kombëtar dhe lokal ose përfshirjen në procesin e bërjes së politikave në lidhje me integrimin në BE dhe reformat e BE-së.

Pritet që të sjellët një rezultat - një projekt ose plan avokimi i përbërë nga veprime konkrete avokuese dhe propozime se si të rritet më tej përfshirja dhe roli i OJQ-ve rome në avokim në një vend të caktuar.

Veprimet e avokimit do të përfshijnë OJQ shtesë, si dhe ombrellat e shoqërisë civile evropiane, të cilat në përputhje me aktivitetet vazhduese pas vizitës studimore do të japin udhëzime dhe ide mbi

1. Si të avokojmë duke përdorur standardet e BE-së dhe parakushtet si një argument dhe

2. Cilat praktika të mira nga Evropa mund të zbatohen në nivel lokal dhe kombëtar?

Iniciativat e avokimit do të hartohen nga anëtarët e "Iniciativës Evropiane e Punëtorive Rome", dhe do të mbështeten nga pjesëmarrësit që marrin pjesë në qëndrimin në Brukseli. Pritet të zbatohet një varg metodash si fushata, tryezat e rrumbullakëta, prezantimet brenda komisioneve të Parlamentit dhe të ngjashme. Të gjithë partnerët e projektit do të ofrojnë ekspertizën e tyre në mbështetjen e realizimit të iniciativave të avokimit. Përfaqësuesi i organizatës partnere që mori pjesë në qëndrimin në Bruksel pritet të jetë plotësisht në dispozicion dhe të kontribuojë në punëtoritë.

Punëtorja ishte e përbërë nga 90 seanca, katër seanca në ditë plus aktivitete pas darkës siç parashihet në agjendën origjinale. Trajnerët me përvojë të gjerë në fushën e financimit të BE-së, Avokimit për romët, Integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE dhe Zhvillimin e Kapaciteteve kanë ligjeruar nësesionet e parashikuara.

Arsimi joformal është përdorur si një metodologji kyçe në këtë trajnim. Puna u fokusua për të nënkuptuar mësimnxënie duke ofruar mendime ekspertësh, ndarjen e përvojave, punën e përbashkët, punën në grup dhe diskutime. Trajnerët përdorën prezantime, përpunim të koncepteve, hyrje, materiale të shkruara si artikuj dhe ilustrime dhe studime të rasteve. Metodatat aktive që janë përdorur përmblinin simulime të situatave të dhëna, duke punuar në grupe, diskutime në panele, këshilla dhe loja (energizers).

Trajnimi u krijua për të rritur njohuritë e pjesëmarrësve, për të rritur motivimin dhe për të prodhuar një rezultat të qartë për t'u përdorur më vonë për iniciativa të përbashkëta.



Konkluzionet nga PUNËTORITË

Cila është zgjidhja që romët të mos jenë mënjë minoritet i marginalizuar? Çfarë mund të bëjmë për familjet romë për të shmangur diskriminimin dhe për të rritur gatishmërinë e grupeve të rrezikuara për të marrë pjesë me mundësi të barabarta në fushat e ndryshme të jetës?

Për disa, përgjigja vjen nga bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, me BE-në dhe organizata të tjera ndërkombëtare në mbështetje të të drejtave të Romëve. Duhet të ketë një mënyrë për të zgjidhur problemet me të cilat përballemi çdo ditë. Përmes kësaj, ne e dimë se një nga gjërat më të rëndësishme është të japim informacion në lidhje me historinë tonë, gjuhën tonë dhe rrënjët tona. Njohuria e historisë dhe kulturës romë mund të ndihmojë në ndërtimin e një ndjenjë më të mirë të bashkëjetesës në shoqëri. BE-ja mund të promovojë një iniciativë kulturore për të shpërndarë këtë informacion në lidhje me kulturën romë dhe gjuhën romë dhe traditën në nivel kombëtar.

Pjesëmarrësit nga secilin vend krijuan "Pemën e Problemeve" në të cilën ata vlerësuan arsyet dhe pasojat e problemit, si dhe objektivat. Shembujt poshtë.

Problemi: Mungesa e kapaciteteve për të ndikuar në politikën publike

Arsyet e identifikuar bashkërisht:

- Mungesa e edukimit adekuat si në sasi ashtu edhe në cilësi për arritjen e nivelit të ndikimit;
- Diskriminimi në shumë fusha të jetës së përditshme;
- Interes shumë i ulët në komunitetin R & E për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes;
- Mosmarrëveshjet e brendshme dhe keqkuptimet kryesisht në udhëheqjen e OJQ;
- Mungesa e kapaciteteve për të filluar proceset e ndikimit;

Pasojat e identifikuar bashkërisht:

- Gjatë zgjedhjeve komunitetet keqpërdoren dhe votat e tyre blihen;
- Nuk janë gjendje të avokojnë për ndryshimet e nevojshme për komunitetin;
- R & E janë të diskriminuara dhe injoruar vazhdimisht si nga individët ashtu dhe institucionet;
- Numri i politikave dhe programeve të dizajnuara nuk u shërbejnë R & E ose ndonjëherë kundër interesit të komuniteteve më të marginalizuara dhe të varfra;
- Iniciativat nuk merren seriozisht në konsideratë;

Problemi: Mungesa e kuadrit të të rinjve romë të aftë dhe të arsimuar për përmirësimin e gjendjes së romëve

Objektivat e identifikuar:

- Krijimi i një grupi prej 10 romësh të aftë dhe politikisht të gatshëm për të hyrë në sfida politike në interes të komunitetit rom;
- Krijimi i një grupi prej 20 romësh me aftësi shumë të zhvilluara udhëheqëse si aftësitë komunikuese, menaxhimi i projekteve, avokimi, lobimi, organizimi i komunitetit, anglishtja akademike, guximi dhe vetëbesimi për të hyrë në sfida në interes të komunitetit rom;
- Themelimi i Organizatës Romë Intellektuale Politike që përbëhet nga romë të rinj kompetentë të cilët do të ndikojnë në politikën e përditshme.

Pjesëmarrësit identifikuan mjetet më të dobishme për avokimin e çështjeve romë. Udhëzimet e propozuara listojnë rekomandimet e mëposhtme:

- Mobilizimi efektiv i komunitetit;
- Rritja e vetëdijes së komunitetit për rëndësinë e problemeve me të cilat ballafaqohen, informacionin e detajuar në lidhje me problemin dhe qasjen e mundshme për arritjen e një ndryshimi;
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbështetjen e njerëzve që sjellin ndryshimin;
- Krijimi i një sistemi / mekanizmi për të siguruar llogaridhënien dhe kredibilitetin e përfaqësuesve të ardhshëm të romëve në organizatat vendore dhe kombëtare të ad (partizane dhe jo partizane)
- Kërkesa e transparencës;
- Të sensibilizohen institucionet për problemet romë;
- Ndërtimi i urave ndërmjet partive politike dhe OJQ-ve romë;
- Të sigurohet mbështetja e akterëve kryesorë.

8. MUNDËSITË E FINANCIMIT

Erasmus +

Erasmus+⁴ është Programi i BE-së në fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit për periudhën 2014-20201. Edukimi, trajnimi, të rinjët dhe sporti mund të japin një kontribut të madh për të ndihmuar në trajtimin e ndryshimeve socio-ekonomike, sfidat kryesore me të cilat Evropa do të ballafaqohet deri në fund të dekadës dhe të mbështesë zbatimin e agjendës së politikave evropiane për rritjen ekonomike, punësimin, barazinë dhe përfshirjen sociale. Programi Erasmus + është i dizajnuar për të mbështetur përpjekjet e Vendeve të Programit për të shfrytëzuar në mënyrë efikase potencialin e talentëve dhe pasurive shoqërore të Evropës në një perspektivë të të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke lidhur mbështetjen për të mësuarit formal, joformal dhe joformal në të gjithë arsimin, trajnimin dhe fushat rinore. Programi gjithashtu rrit mundësitë për bashkëpunim dhe mobilitet me vendet partnere, veçanërisht në fushat e arsimit të lartë dhe rinisë. Në përputhje me një nga elementët e rinj të futur në Traktatin e Lisbonës, Erasmus + gjithashtu mbështet aktivitetet që synojnë zhvillimin e dimensionit evropian në sport, duke promovuar bashkëpunimin midis organeve përgjegjëse për sport. Programi promovon krijimin dhe zhvillimin e rrjeteve evropiane, duke ofruar mundësi për bashkëpunim mes palëve të interesuara dhe shkëmbimin dhe transferimin e njohurive dhe njohurive në fusha të ndryshme që lidhen me sportin dhe aktivitetin fizik. Ky bashkëpunim i përforcuar do të ketë efekte pozitive në zhvillimin e potencialit të kapitalit njerëzor të Evropës duke ndihmuar në reduktimin e kostove sociale dhe ekonomike të pasivitetit fizik. Programi mbështet veprimet, bashkëpunimin dhe mjetet në përputhje me objektivat e Strategjisë Evropiane 2020 dhe iniciativat e saj kryesore, si Rinia në lëvizje dhe agenda për shkathtësi të reja dhe vende pune. Programi gjithashtu kontribuon në arritjen e objektivave të Kornizës Strategjike të Arsimit dhe Formimit për Bashkëpunimin Europian në Arsim dhe Trajnim dhe të Strategjisë Evropiane të Rinisë përmes Metodave të Hapura të Koordinimit. Nga ky investim në njohuri, aftësi dhe kompetenca do të përfitojnë individët, institucionet, organizatat dhe shoqëritë në tërësi duke kontribuar në rritjen dhe sigurimin e barazisë, prosperitetit dhe përfshirjes sociale në Evropë dhe më gjerë.

Erasmus + promovon çasjen e hapur në materiale, dokumente dhe media që janë të dobishme për mësim, mësimdhënie, trajnim, punë rinore dhe prodhohen nga projektet e financuara nga Programi. Përfituesit e granteve Erasmus + për prodhimin e këtyre materialeve, dokumenteve dhe mediave në kuadër të çdo projekti të financuar duhet t'i bëjnë ato të disponueshme për publikun, në formë digjitale, lehtë të çasshme nëpërmjet internetit nën licenca të hapura. Sidoqoftë, përfituesit lejohen të përcaktojnë nivelin më të përshtatshëm të çasjes së hapur, duke përfshirë kufizimet (p.sh. ndalimin e shfrytëzimit komercial nga palët e treta) nëse është e përshtatshme në lidhje me natyrën e projektit dhe llojin e materialit. Kërkesa për qasje të hapur nuk cenon të drejtat e pronësisë intelektuale të përfituesve të granteve.

⁴ http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus/files/files/resources/erasmus-plus-programme-guide_en.pdf

Erasmus + përfshin një dimension të fortë ndërkombëtar (dmth. Bashkëpunimin me vendet partnere) sidomos në fushat e arsimit të lartë dhe rinisë. Në fushën e arsimit të lartë, Erasmus + mbështet veprimet kryesore në vijim duke synuar bashkëpunimin me vendet partnere:

- Lëvizshmëria ndërkombëtare e kredive (studimore) e individëve dhe Diplomave të Përbashkëta Master të Erasmus Mundus (nën Veprimin Kryesor 1) promovimi i mobilitetit të nxënësve dhe stafit nga dhe në Vendet Partnere;
- Projektet për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë (nën Veprimin Kryesor 2) promovimin e bashkëpunimit dhe partneriteteve që kanë ndikim në modernizimin dhe ndërkombëtarizimin e institucioneve dhe sistemeve të arsimit të lartë në vendet partnere, me një fokus të veçantë në vendet partnere fqinje me BE;
- Mbështetje për dialogun e politikave (nën Veprimin Kryesor 3) nëpërmjet rrjetit të Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë në vendet Partnere fqinje me BE, shoqatën ndërkombëtare të të diplomuarve, dialogun politik me Vendet Partnere dhe atraktivitetin ndërkombëtar dhe ngjarjet promovuese;
- Aktivitetet e Jean Monnet me qëllim të nxitjes së mësimdhënies, hulumtimit dhe reflektimit në fushën e studimeve të Bashkimit Evropian në mbarë botën.

Në fushën e të rinjëve, Erasmus+ përkrah Veprimet si më poshtë:

- Mobiliteti i të rinjëve dhe aktivistëve rinor (nën Veprimin Kryesor 1), promovimin e Shkëmbimeve Rinore, Shërbimin Vullnetar Evropian dhe mobilitetin e aktivistëve rinor në bashkëpunim me Vendet Partnere të BE-së;
- Projektet për ngritjen e kapaciteteve në fushën e të rinjëve (nën Veprimin Kryesor 2) promovimin e bashkëpunimit dhe aktiviteteve të lëvizjes që kanë një ndikim pozitiv në zhvillimin cilësor të punës rinore, politikave rinore dhe sistemeve rinore, si dhe njohjen e arsimit joformal në vende partnere, veçanërisht në vendet e Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit (AKP), Azisë dhe Amerikës Latine;
- Përfshirja e të rinjve dhe organizatave rinore nga Vendet Partnere fqinje me BE-në në Dialogun e Strukturuar të të Rinjve (nën Veprimin Kryesor 3) përmes pjesëmarrjes së tyre në takimet, konferencat dhe ngjarjet ndërkombëtare që nxisin dialogun mes të rinjve dhe vendimmarrësve. Përveç kësaj, veprime të tjera të Programit (Partneritetet Strategjike, Aleancat e Njohurive, Aleancat e Aftësive të Sektorëve, Partneritetet Bashkëpunuese) janë gjithashtu të hapura për organizatat nga vendet partnere, për aq sa pjesëmarrja e tyre sjell një vlerë të shtuar në projekt.

CILA ËSHTË STRUKTURA E PROGRAMIT ERASMUS+?

Me qëllim që t'i arrij objektivat, Programi Erasmus+ i zbaton Veprimet e mëposhtme:

VEPRIMI KYÇ 1 – MOBILITETI I INDIVIDËVE

Ky veprim kyç mbështet:

- Mobilitetin e nxënësve dhe stafit: mundësi për studentët, të trajnuarit, të rinjtë dhe vullnetarët, si dhe për profesorët, mësuesit, trajnerët, aktivistët rinor, stafin e institucioneve të arsimit dhe organizatat e shoqërisë civile për të ndërmarrë një përvojë mësimore dhe / ose profesionale në një vend tjetër;
- Diplomë Master e Përbashkët Erasmus Mundus: programe të nivelit të lartë të integruar ndërkombëtar të studimeve të ofruara nga konsorciumet e institucioneve të arsimit të lartë që japin bursa të plota të shkallës së parë për studentët më të mirë në mbarë botën;
- Erasmus + Master Huazim: studentët e arsimit të lartë nga vendet e programit mund të aplikojnë për një hua të mbështetur nga Programi për të shkuar jashtë vendit për një Diplomë të plotë Master. Studentët duhet t'i drejtohen bankave kombëtare ose agjencive të kredive studentore që marrin pjesë në skemë.

VEPRIMI KRYESOR 2 - BASHKËPUNIMI PËR INOVACION DHE SHKËMBIMIN E PRAKTIKAVE TË MIRA

- Ky veprim kyç mbështet:
- Partneritetet Strategjike Transnacionale që synojnë të zhvillojnë iniciativa që trajtojnë një ose më shumë fusha të trajnimit të arsimit dhe rinisë dhe të nxisin inovacionin, shkëmbimin e përvojave dhe njohurive ndërmjet llojeve të ndryshme të organizatave të përfshira në arsim, trajnim dhe rini ose në fusha të tjera relevante. Aktivitete të caktuara të mobilitetit mbështeten për aq sa ato kontribuojnë në objektivat e projektit;
- Aleancat e Njohurive ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe ndërmarrjeve që synojnë nxitjen e inovacionit, sipërmarrjes, krijimtarisë, punësimit, shkëmbimit të njohurive dhe / ose mësimdhënies dhe mësimi multidisiplinar;
- Aleancat e Aftësive Sektoriale që mbështesin hartimin dhe dhënien e kurrikulave të përbashkëta të formimit profesional, programeve dhe metodologjive të mësimdhënies dhe trajnimit, duke u mbështetur në evidencën e tendencave në një sektor të caktuar ekonomik dhe shkathtësive të nevojshme për të punuar në një ose më shumë fusha profesionale;
- Projektet për ngritjen e kapaciteteve që mbështesin bashkëpunimin me Vendet Partnere në fushat e arsimit të lartë dhe rinisë. Projektet për ngritjen e kapaciteteve synojnë të mbështesin organizatat / institucionet dhe sistemet në procesin e modernizimit dhe ndërkombëtarizimit të tyre. Disa lloje të projekteve të ndërtimit të kapaciteteve mbështesin aktivitetet e mobilitetit për aq sa ato kontribuojnë në objektivat e projektit;
